



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 13.10.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 10.10.2023, të parashtruar nga Operatori ekonomik “FINALING”, SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Renovimi dhe pajisja e Qendrës së Komuniteteve (parashkollor) në Ali Ibra Gjakovë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-9100-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-137 -521, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: “FINALING”, SH.P.K. e dt.10.10.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Renovimi dhe pajisja e Qendrës së Komuniteteve (parashkollor) në Ali Ibra Gjakovë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-9100-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-137 -521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të datës 03.10.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë: 03.10.2023;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “FINALING”, SH.P.K. me dt.10.10.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovimi dhe pajisja e Qendrës së

Komuniteteve (parashkollor) në Ali Ibra Gjakovë”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit-
632-23-9100-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-23-137 -521

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 11.10.2023, ka shqyrtuar kërkesën në
fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj nuk qëndron, sepse Autoriteti Kontraktues në FDT-ë, ka kërkuar që :

**Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së
ngjajshme në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë).
Në një vlerë prej jo më pak se 85.000,00€, në rast konsorciumi lideri duhet të ketë të paktën 60%
kontrata të natyrës së ngjajshme.**

Ju keni prezantuar tri kontrata, ku vetëm dy prej tyre janë punë dhe plotësojnë kërkesat e
Autoritetit Kontraktues në FDT-ë, kurse njëra është furnizim dhe nuk mund të mirret për bazë.
Me dt.21.09.2023, ju kemi kërkuar sqarime shtesë të cilat nuk i keni sjellur dhe Autoriteti
Kontraktues ka vazhduar me Operatorin Ekonomik të radhës.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane
OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj
për: 
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

